

Bolshevizma a çkatërimi i njerëzimit

Hafiz Ali Korça

Bolshevizma s'pajton kurrë

Me dinin e Muhamedit

Çelët do ta kenë luftën

Gjer ditën e Kijametit.

**Tiranë
Korrik 2003**

Titulli i origjinalit: **Bolshevizma a çkatërimi i njerëzimit**

Autor: **Hafiz Ali Korça**

Redaktor: **Roald A. Hysa**

Pajisi me shënime: **Justinian Topulli**

Radhiti: **Armanda Kodra**

Përkujdesja kompiuterike

dhe ballina: **KM & RH**

Boton: **JEHONA**

© Të gjithë të drejtat e këtij botimi janë të rezervuara. Ndalohet ribotimi apo riprodhim i pjesshëm pa lejen e botuesit.

Hafiz Ali Korça – (1873-1956)

Patriot dhe veprimtar i shquar islam

Ka lindur në Korçë më 5 prill 1873, i biri i Iljaz Efendiut figurë e njohur në qytet, po ashtu edhe si familje intelektuale e fetare. Në ato momente qyteti i Korçës ishte bërë epiqendër e lëvizjes kombëtare por edhe ku ishte përqendruar propaganda antishqiptare fanariote greke. Vetëm në zonën Berat-Korçë në atë kohë numëroheshin 126 shkolla greke të të gjitha profileve. Pikërisht për këtë edhe veprimtaria e rilindasve të asaj kohe u përqendrua në Korçë. Në një kohë të tillë me shumë trazira lindi edhe Hafiz Ali Korça. Në familje merr një edukatë të shëndoshë dhe qysh në moshën dymbëdhjetë vjeç arrin të mësojë përmendësh Kuranin duke u bërë hafiz, kështu edhe i hapet atij rruga drejt dijeve të pafundme të Islamit. Vazhdon shkollën e mesme (idadijen) po në Korçë, ku edhe e zotëron mirë turqishten dhe frëngjishten, që e ndihmon të njohi më vonë edhe kulturën perëndimore. Studimet e larta universitare i kryen në Stamboll ku përvetëson përveç të tjerave shkëlqyeshëm edhe gjuhët arabe dhe perse. Merr një kulturë të plotë klasike, duke i perfeksionuar studimet e tij në disa drejtime, por veçanërisht në fushën e islamistikës. Aty njihet me mendimet e Ibni Rushdit, Ibni Sinës, me poezinë e Ibni Rrumit, Omer Khajamit etj. Qysh kur ishte student inkadrohet në Lëvizjen Kombëtare dhe i përjeton

hallet dhe problemet që po kalonte në ato çaste Shqipëria. Pasi mbaron studimet pavarësisht nga specialiteti i zgjedhur jep mësim në gjimnazin e Korçës edhe në lëndët natyrore si: astronomi, gjeometri, matematikë etj. Gjatë viteve 1918-1924 ka qenë Kryetar i Këshillit të Naltë të Sheriatit, si dhe iniciatori i hapjes së medresesë së mesme në Tiranë dhe njëkohësisht mësimdhënës aty. Pjesën më të madhe të krijimtarisë letrare të Hafiz Aliut e përbën poezia që e bëri të njohur brenda dhe jashtë vendit. Ka shkruar disa vepra poetike origjinale si “Shtat ëndrat e Shqipërisë” (1924), “Mevludin”, “Jusufi dhe Zelihaja”, “Historija e shenjtë dhe të katër Halifetë” etj. Hafiz Aliu shquhet kështu në fushën e krijimtarisë islame si një poet kalibri duke shënuar një hop të rëndësishëm cilësor. Epopeja në vargje “Historija e shenjtë dhe të katër Halifetë” me 75.000 vargje, si dhe Mevludi në shqip paraqesin aftësitë e tij maksimale dhe e bënë të njohur atë. Vëllimi poetik “Historija e shenjtë dhe të katër Halifetë” paraqet vlera reale të mendimit dhe konceptimit të drejtë Islam të parimeve themelore mbi të cilat ndërtohet Feja Islame. Me këto dy vepra ai afirmohet si poet i talentuar që mbështetet në tematikën e tij, në histori dhe në Kuran duke krijuar kështu një vepër me përmbajtje interesante dhe me vlera artistike. Qysh nga viti 1900, bëhet i ndjeshëm kontributi i tij për tekstet shkollore, për medresetë me tekste origjinale dhe të përkthyer. Ka dhënë një kontribut të gjerë në kuadrin e publicistikës, duke botuar shkrime të ndryshme në gazeta e revista të ndryshme brenda vendit si në gazetën “Korça” dhe jashtë vendit në gazeta si *Sabah*, *Sirati Mustekim*, *Aksham*, *Es-sijasetu* etj. Po ashtu ka dhënë një kontribut të ndjeshëm në revistën e Komunitetit Musliman “Zani i Naltë”, si në mendimin islam po ashtu edhe me komente të ndryshme nga

Kurani Fisnik, komente që i përkasin pjesës së tridhjetë të Kuranit (Xhuzi Amme), të kaptinave (sureve) Maunë, Nasër, Kadër, Fatiha, Tekathur, Humeze, Alak, Zilzaleha, Duha, Felek dhe Nas. Kështu i paraprin punës voluminoze të Hafiz Dalliut në komentimin e Kuranit Fisnik. Një nga fushat ku Hafiz Aliu u shqua gjerësisht ishte edhe ajo e predikimit, sidomos si hatib i mirëfilltë paraqitet të premtëve, por edhe në hutbet (predikimet) e bajrameve. Në to ai trajton tema sociale që e shqetësonin Shqipërinë e atëhershme. Përkthen në shqip nga persishtja Rubairat e Omer Khajamit, duke i cilësuar nën termin shqip “katrorë” dhe pati një debat të gjerë për këtë me Fan Nolin. Përkthen gjithashtu edhe Gjylistanin (Trëndafilishten) e poetit pers Saadiut. Këto dy përkthime reflektojnë gjerësisht njohjen e gjuhës, letërsisë dhe kulturës perse nga ana e Hafiz Aliut. Mendohet që këtë punë ta ketë nisur nga fillimi i shekullit XX. Është e ditur që edhe para tij ka pasur shumë të tjerë që e kanë ditur dhe kanë qenë njohës profesionistë të gjuhës perse, por iniciativa dhe merita kryesore për këto përkthime i takon kryesisht Hafiz Ali Korçës për pasurimin e letërsisë tonë me këto dy kryevepra të letërsisë botërore. Gjithashtu ai ka qenë i njohur edhe me kulturën e letërsinë arabe si dhe me mendimtarët (ulematë) më të mëdhej arabë të kohës. Porse vepra e tij më e shquar për ne është “*Bolshevizma çkatërim i njerëzimit*” si kulmi i veprimtarisë së tij patriotike në periudhën 1920-’25 kundra përhapjes në Shqipëri të ideologjisë mashtruese bolshevike. Hafiz Ali Korça si askush tjetër në lëvizjen tonë politike ndërtoi një vision të qartë dhe largpamës për të ardhmen jo vetëm kombëtare, por edhe gjithënjëzore. Këtë konceptim pak kozmopolit e universal ai e ndërtoi në veprën “*Bolshevizma çkatërimi i njerëzimit*” 1925. Pikërisht në këtë vepër, e cila duhet

studiuar më gjerësisht për të parë konceptin largpamës dhe të gjerë që e karakterizoi gjithmonë Hafiz Aliun dhe për të cilin pati pasoja të ndjeshme në jetën e tij private. Me kohë Hafiz Aliu do të hetojë rrezikun e bolshevizmit dhe ideve të importuara ruse, i cili e çonte kryet lart në emër të barazisë e drejtësisë, duke krijuar një fuqi të madhe të ashtuquajtur “proletariat” për ta mbisunduar botën. Vepra “*Bolshevizma çkatërimi i njerëzimit*” (1925) shënon fazën e pjekurisë politike të Hafiz Aliut. Ai përmes shënimeve statistikore, thekson shkatërrimet e mëdha që kishin bërë bolshevikët. Në një mënyrë apo në një tjetër, me anë të kësaj vepre ai kërkon shpëtimin e atdheut nga kjo sëmundje e rëndë duke konstatuar: *Si çdo atdhetar dëshiron që shtetit dhe kombit të vet t'i shërbejë sipas fuqisë që të ketë.* Na duhet të përmendim që një pjesë e mirë dhe e ndjeshme e veprës së tij në dorëshkrim është zhdukur. Kjo bëhet e kuptueshme si pasojë e rrethanave historike e politike të krijuara, të Shqipërisë së pas Luftës së Dytë Botërore dhe sistemit diktatorial që e pasoi për një periudhë të gjatë gati pesëdhjetëvjeçare. Kontributi i tij është shumëplanësh në jetën kulturore dhe sociale të kombit tonë. Ai përfshin disa fusha: të gjuhës, letërsisë, arsimit, islamistikës, publicistikës, mendimin filozofik e politik, lëvizjen kombëtare etj. Për këtë duhet ndalur dhe duhen zgjeruar më tepër studimet mbi këtë figurë poliedrike shqiptare, e cila mund të shihet në shumë aspekte. Një vend të veçantë nga ana studimore paraqet edhe letërkëmbimi i tij me figura të politikës dhe shkencës. I damkosur nga regjimi komunist si klerik reaksionar dhe pjesëtar i Ballit Kombëtar dënohet nga “Gjyqi i Popullit”. Vitet e fundit të jetës i kalon në Tiranë e më pas i internuar në Kavajë, mu për pikëpamjet e tij antikomuniste ku edhe vdes në mjerim të plotë ky mendimtar, patriot dhe

veprimtar i shquar islam më 1956. Pavarësisht nga paragjykimet politike që i janë bërë ai mbetet një figurë e shquar e plejadës së klerikëve militantë që ishin të gatshëm të sakrifikonin edhe jetën e tyre për hir të së vërtetës. Duke u munduar të nxjerrim në pah disa detaje të figurës së tij, nuk mendoj që e kemi plotësuar borxhin që kemi ndaj kësaj figure të shquar. Në këtë paraqitje të shkurtër të jetës dhe të veprës së Hafiz Ali Korçës, jam mbështetur gjerësisht në monografinë e dr. Ismail Ahmedit: “Hafiz Ali Korça – Jeta dhe vepra”, botuar në Shkup më 1999.

Dy fjalë rreth këtij libri dhe kohës kur doli nga botimi

Megjithëse nga sasia e materialit që paraqet në këtë studim të shkurtër, ajo ka dalë në formën e një broshure dhe për nga ana studimore këtu paraqitet modestisht; me këto faqe Hafiz Ali Korça hyn denjësisht në historinë e mendimit politik si i pari person që e denoncon publikisht ideologjinë bolsheviko-komuniste. Ai në këto faqe të pakta nëpërmjet disa të dhënave ve në dukje rrezikun që i kanosej nga ideologjia bolshevike shoqërisë shqiptare, e karakterizuar nga ekuilibre delikate, në të cilën gjendej në atë kohë Shqipëria e sapodalë nga Lufta I Botërore, e cila e dëmtoi shumë vendin. Pikërisht në fillimin e viteve '20-të shkëputen lidhjet e Shqipërisë me Turqinë pas rënies së kalifatit dhe shkatërrimit të tij prej Mustafa Qemalit. Në çastet e pasluftës i gjithë Perëndimi kalon në një fazë trazirash me lëvizje tronditëse sociale. Pas fitores së Revolucionit Bolshevik të Tetorit në Rusi me në krye Leninin, gjithashtu do të bënte që ekuilibret botërore të

ndryshonin ndjeshëm. Rusia u gjend para ndryshimeve radikale dhe të menjëhershme. “Dekreti mbi tokën” bëri që e gjithë prona private e çifligarëve, carit dhe e institucioneve fetare t’i kalonte sovjetëve të fshatarëve, duke u kthyer në një pronë të përbashkët. Menjëherë pas dy vjetësh po me iniciativën e Leninit në kundërpërgjigje të Perëndimit, i cili përkrahu gjeneralët kozakë: Kollçakun, Denikinin, Judeniçin, Vrangelin etj., hapet në Moskë, Kongresi I i Internacionales III Komuniste. Menjëherë pas kësaj Evropën e përfshin një valë grevash, protestash e revolucionesh bolshevike siç ishin: ai në Gjermani i organizuar nga krerët e PK-së Gjermane, Roza Luksemburg dhe Karl Libkneht kur në prill të 1919-ës e shpallin Landin e Bavarisë, Republikë Sovjetike. Po ashtu Bela Kun, udhëheqësi i komunistëve hungarezë, i përgatitur në Rusi, kryeson Republikën Sovjetike të Hungarisë dhe menjëherë me anë të një fushate ushtarake dhe të disa fitoreve të njëpasnjëshme pushton Çekinë në qershor të 1919-ës dhe ngre një tjetër republikë sovjetike atje. Megjithatë një ushtri rumune e bën atë që të tërhiqet shumë shpejt, por edhe si rezultat i një politike të brendshme të dobët Republika Sovjetike e Hungarisë detyrohet të bjerë dhe Kuni largohet nëpërmjet Vjenës për në Moskë. Atje, pas shumë vitesh qëndrimi akuzohet për trockizëm dhe në një nga spastrimet e bëra nga Stalini ekzekutohet në nëntor të 1939-ës. Po kështu Italia, Franca, Anglia e Amerika përfshihen nga një valë grevash e protestash punëtore në mbështetje të Ruisë Sovjetike, ndërsa në Itali Musolini hip në pushtet me Partinë Fashiste, e dalë fillimisht si fraksion nga radhët e Partisë Socialiste. Po ashtu gjendja e brendshme e Shtetit Shqiptar të dalë pas Kongresit të Lushnjes të vitit 1920 ishte tronditur disa herë radhazi. Qeveria e Lushnjes

menjëherë iu desh të ballafaqohesh me një luftë të pabarabartë me italianët në Vlorë dhe më pas me disa kryengritje afatshkurtra për të ardhur më pas në të ashtuquajturin Revolucionin Demokratiko-borgjez të Qershorit të 1924-ës, me në krye Fan Nolin dhe me mbështetjen e regjimenteve të Shkodrës me komandant, kolonel Rexhep Shalën dhe ai i Përmetit me komandant, kolonel Kasem Qafëzezi. Si rezultat i politikës së dobët të brendshme dhe të jashtme të Nolit dhe me përkrahjen e Fuqive të Mëdha të Perëndimit, në dhjetor të 1924-ës rikthehet në pushtet Ahmet Zogu. Kjo është pak a shumë në vija të trasha gjendja e jashtme dhe e brendshme në të cilën e pa dritën e botimit kjo broshurë. Pikërisht kjo është edhe merita e Hafiz Ali Korçës që diti të diktojë në ato [aste kush ishte rreziku real që po i kanosej shqiptarëve, rrezik që po i kanosej edhe tërë Botës. Ai në këtë vepër i bën një analizë të hollësishme bolshevizmit, lidhur me “parimet” njerëzore, drejtësinë, luftën e klasave, punën etj, mbi të cilat ndërtohet sistemi bolshevik. Këtu ai ve në dukje dëmet e ndryshme që i solli pushteti sovjetik popullit të vet, qoftë nga ana morale, apo materiale e shpirtërore. Kjo vepër tregon njëkohësisht edhe pjekurinë politike të Hafiz Aliut. Pasi ka vënë në dukje dëmet morale dhe shpirtërore që solli vendosja e regjimit bolshevik në Rusi, ai me anë statistikash nxjerr në pah dëmet materiale në ushqim, bagëti, njerëz dhe se çfarë i bëri fesë kjo ideologji tashmë shtetërore. Statistikat e dëmeve njerëzore i ka nxjerrë nga Çeka e Feliks Xherxhinski, embrioni fillestar i KGB-së së mëvonshme. Me këtë ai kërkon t’i paralajmërojë shqiptarët qysh herët për dëmet që sjell kjo ideologji si shkatërruese e të gjitha vlerave njerëzore të mirëfillta, ku ndër to kryesorja është feja dhe familja. Njëkohësisht Ai vëren me zgjuarësi se të gjitha

ndarjet e fraksionet qysh në fazat e para të historisë së zhvillimit islam, kanë qenë prodhim i ndërgjegjshëm i organizimit dhe i përzierjeve çifute. Qysh në fillim duhet përmendur copëtimi i umetit islam me rastin e shpalljes së Ali ibn Ebi Talibit, dhëndrit të Profetit Muhamed a.s., si “Perëndi”. Këtë huti e krijoi çifuti i veshur me petkun e Islamit Abdullah Sebe’, i cili shkaktoi përçarjen më të madhe në të gjithë historinë islame, pasojat e së cilës do të ndihen gjatë tërë historisë.

Mu pikërisht për këto arsye si dhe ringjalljen e punës së brezave të shkuar në të mirë të fesë dhe të këtij kombi, për dashurinë dhe përkushtimin që patën ato për këtë binom, ndërmorëm edhe ribotimin e plotësuar të këtij libri të vogël, por të rëndësishëm nga pikëpamja e mendimit politik e fetar. Ai nuk është thjeshtë një ribotim, por është plotësuar me shënime dhe sqarime për të plotësuar një kuadër, i cili mund të quhet edhe si një libër krejtësisht i ri në vetvete. Dëshira jonë e mirë është ta paraqesim punën në dritën e duhur dhe jo thjesht për të bërë një ribotim.

Roald A. Hysa

Qëllimi i shkrimit

Si çdo atdhetar që dëshëron, që Shtetit dhe kombit të vet t'i shërbejë sipas fuqisë që të ketë. Mizën e dheut e pyetën, ku po shkon? Tha: “Në Qabe”. I thanë: “A me këto këllqe do të shkosh”? Iu përgjigj: “A po shkoj me këtë qëllim të mirë, edhe në mos mbërritsha sevapi i haxhillëkut më shkruhet”. Kështu edhe unë si miza e dheut po mundohem t'i shërbej Atdheut dhe bashkëatdhetarëve të mi sipas fuqisë që kam. Këtu në këtë libër dua të flas pak përmbi bolshevizmën, e cila po rrënon botën dhe njerëzimin. Bolshevizma, sot sekujt po i tingëllon në vesh. Këtu do të flasim përmbi burimin dhe shkatërrimin e saj me disa dokumenta të gjalla. Për të shkruar një libër kësisoj duhet një kapital i mjaftueshëm; por të ndershmit këndues duke marrë parasysh qëllimin që bazohet thjeshtë përmbi një shërbim fetar edhe kombëtar, shpresoj se përmbi gabimet tona do të hedhin syrin e fajmbulimit.

O ti që më thua fort paske lajthitur
S'më thua ti vallë nga qjelli ke zbritur?
Porse nuk më dukesh të jesh aq'i quar
Më tepër se mua do të kesh haruar!

Shkrimtari kritikohet, por unë dua të them se çdo lule që s'ujitet vyshket, edhe çdo mëndje që s'kalitet ndryshket. Pra, atëhere njeriu duhet të shkruajë!

H. Ali

Bolshevizma dhe Myslimanizma

Para se të fillojmë të flasim për çështjen, të flasim pak përmbi rrënimet njerëzore dhe qytetërore që i ka sjellë botës rreziku i kuq e i zjarrtë i bolshevizmit. Për ta ndriçuar duhet të tregojmë thelbin e këtij ajeti që urdhëron Zoti në Suren Shura (ajeti 27):

وَلَوْ بَسَطَ اللَّهُ الرِّزْقَ لِعِبَادِهِ لَبَغَوْا فِي الْأَرْضِ وَلَئِن يَسُدَّ مَا يَهْدَاهُ لَإِنهٗ بِعِبَادِهِ خَبِيرٌ بَصِيرٌ

“Zoti me madhërinë e vet që ta shtronte e ta shtrinte ushqimin e pasurinë njësoj për të gjithë njerëzit, njerëzija padyshim në faqe të dheut do të bënë kryengritje të rrepta, edhe do të bëheshin të gjithë rebelë”. Dmth, Zoti po t'i

bënte të gjithë njerëzinë njëlloj nga ana e pasurisë, njeri-tjetrin do të mos e respektonin, se kush do të thoshte unë jam, i vogli të madhin nuk do ta njihte, se kush do të dëshironte t'i jepte urdhra tjetrit por askush s'do ta dëgjonte tjetrin dhe kështu do të hante njeriu-njerinë, raca e njeriut do të shfarosej, bota do të shkretohej. Pra, Zoti pasurinë e ndau duar-duar që të mundohet secili të vrasë mendjen, të përpiqet të punojë që kësisoj të bëhet i pasur e të lartësohet si në pasuri ashtu edhe në dituri, e në mjeshtëri etj...

Nëse pasuria do të ishte e caktuar dhe e pandryshueshme, askush nuk do ta vriste mendjen, askush nuk do të lodhej, askush nuk do të punonte; atëherë qytetërimi s'do të lindte, edhe bota do të jetonte në egërsi. Në një ajet tjetër urdhëron:

و أن ليس للإنسان إلا ما سعى

“Njeriut nuk i takon veçse ajo që ai punoi” (Sure Nexhm: 39)

Në tjetër ajet urdhëron:

أ فحسبتم أنما خلقتناكم عبثا

“Ç’kujtoni se mos ju krijova kot”? (Sure Mu’minun: 115)

Puno, puno Zoti thotë

Mos rri duarlidhur kot!

Në një vend tjetër urdhëron:

“Njeriu pandeh se do të lihet ashtu i harruar në heshtje? Do t’i merren të gjitha hesapet”.

Siç kuptohet nga ajetet e sipërshënuara, njëri që i thotë vetes njeri duhet të mos e poshtërojë veten, por të përpiqet e të mundohet që çdo send të pëlqyeshëm e njerëzor që i dëshiron shpirti ta shtjerë në dorë.

Ai që përpiqet i arrin dëshirës

Në je burrë kurrë mos i-u ndaj së mirës!

Vërtet e gjithë bota jemi vëllezër, jemi gjymtyrë të njëri-tjetrit, punojmë njëri për tjetrin. Bie fjala një afrikan mundohet në shkretëtirat e zjarrta të Afrikës, mbjell pambuk e tjetri gjuan egërsira në Siberi për lëkurë që të veshim ne, por edhe ne punojmë me kazëm, mihim tokën me bel për të fituar pak të holla që t’u japim atyre. Kësisoj punon secili rob për vëllanë e tij që s’e njeh aspak. Të ishte pasuria njësoj, vallë kush do të punonte e do të kujtonte vëllanë e tij që jeton në tjetër vend!

Vjershë

Lëvdime të qofshin, o Zot i vërtetë!

Gjithë njëri për tjetrin punojmë në jetë!

Bolshevizma nga doli?

Druri zekum¹ e i mallkuar i boshevizmit, 70-80 vjet më parë u mboll nga Karl Marksi² dhe në kohërat e fundit u ujit nga Lenini³. Por përpara se të flasim mbi mbjelljen e kësaj peme të egër e të mallkuar, po ju tregojmë vëllezërve tonë armiqësinë e thellë e të fortë që ushqejnë çifutët kundra myslimanëve. Zoti në suren El-Maide (ajeti 82) urdhëron:

لتجدن أشد الناس عداوة للذين آمنوا اليهود و الذين أشركوا

“(I dashuri im Muhamed!) **Çifutët dhe idhujtarët** (shtatore-falësit) ***padyschim ke për t’i gjetur armiqtë më të ashpër të botës për besimtarët***”.

Vërtet botës myslimane ligësitë që i kanë ardhur prej çifutëve dhe prej mushrikëve s’i kanë ardhur prej askujt. Shumë çifutë qëllimisht kanë pranuar të bëhen muslimanë

¹ Pemë, ngrënia e së cilës u shkakton vuajtje banorëve të Xhehenemit.

² Karl Henrik Marks (1818-1883) - Themelues i teorisë famëkeqe të Marksizmit. Bashkë me Frederik Engelsin ai formuloi shumë prej teorive të socializmit dhe komunizmit modern. I ati i Karlit ishte një avokat **çifut**, i cili u konvertua gjoja së bashku me familjen e tij në të krishterë, për të ruajtur punën e tij në shtetin prusian. Që në rini Karl Marksi u ndikua fuqishëm nga një grup radikal i quajtur “*Të Rinjtë Hegelianë*”, të cilët kërkonin të aplikonin idetë hegeliane kundra fesë së organizuar dhe autokracisë prusiane. Më 1848 Marksi deklaronte në Manifestin Komunist se e tërë historia njerëzore ishte një histori lufte ndërmjet klasave të shoqërisë. Ai e konsideronte fenë si opium për njerëzit të shpikur nga të pasurit për të nënshtruar të varfërit. Marksizmi lufton pronën private dhe është tërësisht një ideologji materialiste. Sipas Marksit morali është diçka që thyen mekanizmin e prodhimit prandaj duhet flakur jashtë. Vetë Marksi e pranon se pati lidhje me Filozofinë e Cionizmit dhe themeluesin teorik të saj, Moses Hess (mësuesi i Theodor Herzl, themeluesi i Cionizmit modern). Vitet e fundit të jetës së tij do të karakterizohen nga sëmundjet dhe depresioni derisa vdiq më 14 Mars 1883.

³ Lenin, ose Vladimir Iliç Ulianov (1870-1924). Udhëheqës i revolucionit bolshevik dhe teoricien politik i Social-Komunizmit. Disa studime thonë se Lenini ishte me origjinë **çifute** dhe mbante fillimisht një emër të tillë, por që më pas e ndryshoi në atë rus me të cilin edhe njihet, ngjashëm me mikun e tij Leon Trocki.

dhe me atë maskë i kanë prurë turbullirat më të mëdha. Çifuti Abdulla Seluli⁴ që në kohë të Pejgamberit me anën e munafikllëkut (hipokrizisë) ia turbullonte shokët. Çifuti Abdulla Sebe'aja⁵ me petkun e muslimanit, i pruri aq rreziqe atyre sa të ngjethen mishrat. Për të shkaktuar turbullira u thoshte disave: “Hazreti Aliu është Perëndi”. Me t’i hyrë në vesh Aliut sadoqë e mërgoi prej Medines, nga moszhdukja e tij fjala mori bujë. Pas vdekjes së Aliut disa mendjeshkurtërve filloi t’u thotë: “Aliu ishte vetë Isai, erdhi përsëri me tjetër fytyrë, si u vra u ngjit prapë në qiell (hasha) e tjera...” Fjalët e këtij çifuti, pak a shumë kanë lënë vijën e një kërmilli⁶. Thuhet se edhe në luftën pikëlluese të Sifinit⁷ ka luajtur gishtin e Jahudive. Mesxhidi Dirarin – që Pejgamberi e shkatërroi – munafikët çifutë me atë qëllim e patën përgatitur.⁸ Historia me të tillë shembuj është plot.

⁴ Abullah ibn Ubeje ibn Seluli, kreu i munafikëve në Medine, megjithëse nuk kemi ndonjë të dhënë se ishte çifut, ai përkrahte dhe i ndihmonte ata kundra Profetit s.a.v.s. dhe muslimanëve.

⁵ Abullah ibn Seba, apo i njohur si Ibn Seuda, çifut i Jemenit, i cili në mënyrë tinzare pranoi për sy e faqe Islamin gjatë kohës së Uthmanit r.a. dhe ishte ai një nga shkaktarët kryesorë që ndezën fitnen-ngatërresat në të cilën humbën jetën shumë prej sahabeve, ndërmjet tyre Uthmani, Aliu, Talha dhe Zubejri (Allahu qoftë i kënaqur prej tyre). Ai njihet njëkohësisht edhe si themeluesi i parë i Shiave.

⁶ Gjurmë të doktrinave që ai përhapi mund t’i gjejmë edhe te tarikatet sufij që gjenden në vendin tonë ndër më të spikaturat prej tyre ai Bektashian, të cilët besojnë në një trini të tipit të krishterë; Allah-Muhamed-Ali! –Zoti na ruajtë nga blasfemi të tilla!

⁷ Betejë që u zhvillua ndërmjet Aliut r.a. dhe Muavijes r.a. në Sifin (në perëndim të Eufratit) në v. 37 të Hixhrit (Korrik 657).

⁸ Shihni në Kuran, Suren Teube. (H. A.) Ja, se ç’thotë ajeti 107 i kësaj sureje: **“Sa për ata që ngritën xhami duke sjellë prishje dhe mosbesim për të përçarë besimtarët dhe si një pararojë për ata që luftuan kundër Allahut dhe të dërguarit të Tij kohë më parë, ata vërtetë do të betohen**

16

Shumë Pejgamberë i ther' e i vranë

Ndryshuan Teuratin pa bërë gjë s'lanë.

Sa për armiqësinë e mushrikëve të Kurejshëve dhe për ligësitë e tyre që i kanë bërë muminëve (besimtarëve), e di secili musliman. Mevlana Xhelalud-dini në librin e tij Methnevi na kallëzon një ngjarje të gjatë. Shkurtimi është kështu: Në fillim që doli e po përhapej krishterimi, çifutët kanë vranë shumë të krishterë. Por ata sa vriteshin më tepër shtoheshin. Një nga ministrat, mbretit të çifutëve i thotë kështu: Me vrasje nuk po fryhem, nuk po ngopem aspak. Të lutem të më shkurtosh këmbët e duart dhe natën të më lëshosh në aksh udhë që të më shohin të krishterët e të më marrin. Vërtet, me të gdhirë e shohin që po rënkon e po mallkon. I dërguan lajm të madhit të tyre, e ngritën dhe e shëruan. Kur u pyet tha: Unë kisha marrë fenë e krishterë, por me ta kuptuar mbreti, disa herë më këshilloi por s'hoqa dorë. Së fundi, u zemërua më preu këmbët e duart dhe si më hodhi në baltë më tha: Shko tashti të të ngjalli Krishti. Aq shumë falej sa le të paditurit, por edhe priftërinjtë dhe të mëdhejtë i puthnin dorën dhe e njihnin për më të madhin shenjtor. Kishte zgjedhur dymbëdhjetë priftërinj nga më të

se qëllimi i tyre ishte veçse për mirë, por Allahu dëshmon se ata janë padyshim gënjeshtarë”. Shkaku i zbritjes së këtij ajeti ishte fakti se disa prej munafikëve të Medines kërkonin që të krijonin një xhami anti-islame nga ku do të mund të përçanin muslimanët. Ndërkohë që Profeti s.a.v.s. nisej për në Tebuk, ata kërkuan prej tij që të vinte dhe të falej në këtë xhami që ata gjoja e kishin ndërtuar për nevojtarët dhe të sëmurët, të cilët nuk mund të shkonin dot në Xhaminë e Profetit, për të tërhequr në këtë mënyrë muslimanët dhe për të arritur qëllimet e tyre. Profeti s.a.v.s. pa e ditur arsyen e vërtetë u premton se do ta bëjë një gjë të tillë pasi të kthehet nga Tebuk. Allahu i shpalli atij më pas arsyen e vërtetë të ngritjes së kësaj xhamie dhe i Dërguari i Allahut me t'u kthyer urdhëroi për prishjen e kësaj xhamie shërr.

mëdhejtë, të cilëve kokë më kokë fshehtazi sikur u tregonte thellësisht e fshehta të fesë, duke i thënë secilit: “Unë të dua fort, pas vdekjes sime ty kam për të të lënë në vendin tim, ja edhe libri që ke në dorë në të cilin ke të shënuar hollësisht e fesë, pas vdekjes sime do ta kesh një dokument të fortë për të më zëvendësuar”. Sekush nga të dymbëdhjetë shokët e tij me qenë se kishte nga një dokument të fortë, kujtonte se me të vërtetë do të mbetet zëvendës i shenjterisë së tij. Një ditë i thirri një nga një përpara tij dhe veçanërisht secilit i thotë: “Unë nesër do të fluturoj te Zoti, zëvendësi im je ti edhe dokumentin e ke në dorë”. Nga ana tjetër i dërgoi edhe mbretit të tij fjalë që: “Nesër ke për të dëgjuar si do të grihen”. Në mbrëmje helmon veten dhe u gdhii i vdekur.

As dreqit s’i vinë ndër mënt këto punë
Për të shuar fenë mbyl vehten e vetë
Histori e botës nuk e kap gjëkund
Si punoj ky dreqi një shembëll të ketë!

Sekush nga shokët me libër në dorë edhe me rrethin e vet bërtet se unë jam zëvendësi i shenjtorit me dokument të fortë. Bota u përzie, u grinë qindra-mijë duke thënë se ky e ka të saktë e tjetri falco.⁹ Mushrikët e Persisë me maskën muslimane nën kryesinë e Ahmet Karmatit¹⁰ sa bela të

⁹ Thuhet në Azinë e Vogël partitë si Nestorinj, Jakubinjtj etj. ... që asokohe paskan mbetur. (H. A.)

¹⁰ Emri i tij është Ahmed ibn Kasim, u priste rrugën karvaneve tregtare dhe të haxhinjtve, vdiq më 294 h. Është një nga pasardhësit e Hamdan ibn El-Eshath, i mbiquajtur Karmat, themeluesi i sektit shkatërrimtar, konspirativ Keramit, sekt i cili në dukje shfaqej si Shia, por qëllimi i tij ishte shkatërrimi i shtetit Islam.

mëdha i sollën muslimanëve? Nga ajo farë janë dhe Hashashinjtë¹¹ që tronditën botën dhe mbretëria njerëzimshkatërruese e tyre vazhdoi një shekull e ca. (Këta kanë qenë bolshevikë fort të rreptë). Kështu edhe botës së krishtere çifutët i kanë sjellë aq rreziqe e ngatërrime sa s'bëhet hesap. Çifutët si e panë se as botën muslimane, as botën e krishterë veçanërisht (veç e veç) nuk po i fikin dot, pas lidhjes së fshehtë që bënë, shtinë në dorë mbretërimin metalor dhe ekonomik edhe kësisoj po ia arrijnë qëllimit të vet. Nga çifutët e Kudsit (Jeruzalemit) Vahami shpiku masonizmin¹², me anën e së cilës gjoja do të themelonte e përmbante vëllazërinë e përgjithshme. Mirëpo me anën e kësaj ia arritën qëllimit se si muslimanët, ashtu ca më tepër edhe të krishterët i tronditën.¹³ Kësisoj edhe çifuti Karl Marks në shekullin e nëntëmbëdhjetë përgatiti kijametin më të madh, përgatiti atë kijamet që ndën maskën e njerëzimit,

¹¹ Sekt Ismaili, i rrjedhur nga Shiat, i themeluar nga Hasan ibn Sabahu (430H-518H apo 1036-1124). Dallohet për komplete dhe atentate për qëllime politike dhe fanatike fetare. Fjala Hashashij (ASSASSIN) ka hyrë në përdorimin e gjuhëve evropiane; si vrasës i pabesë apo vrasës profesionist.

¹² Freemasonry. Nga ana gjuhësore do të thotë: ndërtuesit e lirë. Organizatë me baza çifute, vepron në mënyrë tepër të fshehtë. Qëllimi i saj është shtrirja e sundimit çifut në mbarë botën. Fillimisht u krijua për të shkatërruar Krishterimin, por në fakt ata luftojnë në përgjithësi besimet fetare, duke i ftuar njerëzit në ateizëm, shthurje dhe anarki. Qëllimet e tyre i mbulojnë nën petkun e Lirisë, Vëllazërisë, Barazisë, Humanizmit etj... Përipiqen të fusin në radhët e tyre persona me influencë në jetën politiko-shoqërore. Këtu mund të përmendim disa prej tyre: Kompozitori Wolfgang Amadeus Mozart (ku opera, *Flauti magjik*, sillet rreth ritualeve masonë) po ashtu edhe Leon Tolstoi ka qenë një prej tyre (një prej veprave të tij siç është *Lufta dhe Paqja*, tregon idetë e tij masoniste për vëllazërinë), Zhan Zhak Ruso, Volteri, Marks, Engelsi etj...

¹³ Përmbi masonizmin do të shkruajmë gjerë e gjatë në një kapitull më vete. (H. A.)

ndën petkun e qytetërimit, brenda në katër-pesë vjet do të shkulte rrënjët e feve, do të shkulte themelin e besimit që ka një Zot, do të gremiste jetën shoqërore, do të rrëronte qeverimet, do të përmbyste rregullimet, edhe do të shpikte turbullimet egërsore. Prej librit që shkruan Xharu-llahu, i cili sot po rënkon në burg në Rusi me hekura në zverk, edhe në këmbë, po qesim këto fjalë: “Në (1914) u hap lufta e përgjithshme. Spriha¹⁴ plakë me petkat flakë mbuloi gjithë botën. Ushtria e madhe (proletariati) dmth bolshevikët, më të varfërit e popullit, që ishin përgatitur 70-80 vjet më parë prej Karl Marksit; të ngratët që ishin helmuar me propagandat helmatare, me këshilla thumbëtore, me fjalët e stolisura gjakësore të tij, u bë revolucioni i tmerrshëm edhe filloi t’i shkulë rrënjët njerëzimit dhe qytetërimit. Vërtet kjo ide sefte (në fillim) u rrëfye si një socializëm, më tëhu (më pas) si veshi petkun e kanunizmës (ligjit) e të bolshevizmit, filloi të gërmadhøjë botën. Ajo socializëm e Karlit me petkun e komunizmit, qytetërimin e Ruisë e përmbysi, fenë e rrënoi, njerëzimin e shkretoi, botën e varfëroi, gjithë besimet i mohoi, ndërtesat e qytetërimit i shkatërroi. Lufta e përgjithshme¹⁵ shkretoi gjithë botën, por ca më tepër Rusinë, sepse pas luftës, ata udhëheqësit e bolshevizmës diplomatët më të rreptë si e panë sheshin më të volitshëm u mblodhën në Rusi edhe bënë revolucionet më të tmerrshme. Mbi këtë revolucion edhe në kishte shpëtuar pa djegur ndonjë qytet a katund a ndonjë i ditshëm pa vranë prej luftës së përgjithshme, edhe ato u dogjën, kundërshtarët u ndoqën, u vranë, u poqën; fetë u çnderuan, faltoret u kthyen në vende vallesh, sallat e gjykatoreve u

¹⁴ Spriha - Në folklor përbindësh i pangopur i ngjashëm me kuçedrën

¹⁵ I referohet Luftës së Parë Botërore.

tronditën, në vend të tyre u ngritën gjyqe ushtarake, komisione të jashtënatyrshme dhe kështu (Çeka)¹⁶, populli i shkretë mbeti midis zjarrit e tymit që dilte prej pallateve, prej faltoreve, prej fabrikave edhe lëvrinin nëpër huret e nxehta dhe gjakrat e derdhura. Në vend të feve po vihej dekalogu i fesë së re, dmth, (dhjetë urdhërat) e shkruara në pllaka të kuqe me shkronja të mëdha. Terbijeja (edukata) u helmua¹⁷, u poshtërua, njerëzimi u fik, egërsimi i moçëm u përsërit.

Shenjë më s'lanë nga lulëzimi

U egërsuan vdiq njerëzimi.

Duke bërë vegël më të këputurit, më të varfërit e popullit, programi i Karl Marksit në Rusi gjeti sheshin më të volitshëm, edhe Komunizmi i bëri ballë gjithë fuqive materiale e shpirtërore dhe nga çdo pikëpamje Rusinë e shkretoi. Ata që besojnë një kijamet, modelin e vogël mundin ta shohin në Rusi. Shumë njerëz të pasur mbetën pa ngrënë, zbathur, zhveshur nëpër gërmadha. Lordët u bënë hamallë. Me qindra-mijëra njerëz të ndershëm, u grinë me thika e u lëvrinë në gjak. Tufani (rrebeshi) i Nuhut në ishte prej ujit, ky ishte tufan gjaku. Karl Marksi miku më i

¹⁶ Çeka – ose VeÇeka, pararendëse e KGB-së famëkeqe ish-shërbimi sekret sovjetik, janë inicialet e “Komisionit të Jashtëzakonshëm të të gjithë Rusive për të luftuar Kundërrevolucionin dhe Sabotimet”, i krijuar më Dhjetor 1917 nën udhëheqjen e Feliks Xherxhinski.

¹⁷ Vetë Lenini deklaronte se në tërë Socializmin shkencor ‘s’ka asnjë s’fje morali’. Po ashtu teoricieni sovjetik J. Pashukanisi thotë: ‘Nëse lidhja e individit me klasën është njëmend aq e gjallë dhe e fortë sa kufijtë e ‘Unit’ të shlyhen, kurse përparësia e klasës bëhet vërtetë identike me përparësinë e personalitetit, atëherë s’ka asnjë kuptim të flitet për përmbushjen e detyrës morale, atëherë nuk ekziston fare fenomeni i moralit’. !!!

fortë i Teuratit¹⁸, një nxënës i lartë e i thellë, porsi deti nga nxënësit e Talmudit¹⁹, me mendjen e hollë dhe djallëzore që pati përgatiti ushtrinë (proletariatit). Pastaj pas 70, 80 vjet kjo hordhi me propagandën e Leninit shkatërroj Rusinë. Ç'thoshte Karl Marksi? Ky i zgjuari i madh, ky exhiniu me nam kur bënte propagandë thoshte që: sëmundja më e madhe e qytetërimit paska qenë kanuni që i jep të drejtë botës të trashëgojë e të zotërojë tokat (çifligjet) edhe ndërtesat! Ilaçi i shërimit të kësaj sëmundjeje na paska qenë revolucioni, diktatura e proletariatit, edhe largimi i shumicës prej të drejtave shoqërore, që kësioj ushtria varfanjake si shtien botën në dorë, edhe si të poshtërohen njerëzit e njohur e të ndershëm, edhe si të rrënohen të gjitha fetë, atëhere do t'u themeloka vllazëri e përgjithshme dhe e vërtetë! Pra, si të bëhen bota mbarë trokë edhe rrozgë, kjo ushtria varfanjake e diktatore paska për të çelur hambarin e përbashkët e të përgjithshëm dhe gjithë njerëzia pa patur as ndonjë diferencë (ndryshim) si baronët, lordët ashtu edhe lypsarët me trajisë në dorë do të mblidhen rreth e rrotull hambarit të çelur në shesh të përgjithshëm²⁰! Gjithë shenjat

¹⁸ Toraja çifute, e cila përbëhet nga pesë librat e parë të Biblës, arabisht- Teurat

¹⁹ Talmudi, janë transmetimet gojore të priftërinjve çifutë të mbledhura në një Libër të quajtur Mishnah në vitin 150. Shërben si plotësues dhe sqarues i Torës.

²⁰ Këtu për të treguar se sa utopik dhe i parealizueshëm është Komunizmi, ia vlen të përmendim një anekdotë që thuhet se ka ndodhur gjatë regjimit totalitar që shkoi. Thuhet se një plak i mençur i paska paguar një shitësi akulloreje një sasi të hollash, të cilin e kishte porositur që derisa të plotësohej shuma e parave ai do t'i jepte falas akullore çdo njeriu që vinte të blinte tek ai. Dhe kështu ndodhi. Njerëzit kur e shikonin se akullorja ishte pa pare filluan të shtyheshin e të vriteshin kush e kush të merrte sa më shumë. Kjo rrëmuje tërhoqi vëmendjen e policisë, e cila menjëherë e pezulloi shitjen e akulloreve dhe kërkoi shpjegime nga shitësi se ç'po ndodhte. Ai i tregoi se si qëndronte puna dhe policët iu drejtuan burrit të moshuar, i cili nga diku aty afër vështronte 'me ëndje' katrahurën që bëhej. Ai iu përgjigj policëve duke iu thënë: Unë jam 22

e qytetërimit, lëndore e shpirtërore po s'u gjermadhuan, në vënd të kanuneve pa u vendosur fuqi e plotë proletariati, turpi, nderi, besimi, feja e ç'i përkasin këtyre po nuk u shkulën, trupi i përgjithshëm njerëzor nuk paska qenë e mundur të ndreqet...! Ashiku (pasionanti) i madh, besniku i fortë i Teuratit edhe çiraku i Talmudit kështu paska menduar! "Lenini e mori me gjithë kamatë, edhe me disa fish kamatë intikamin (hakmarrjen) prej Ruisë për vëllezërit e tij që iu grinë nga ana e perandorisë njëzet a tridhjetë vjet më parë"²¹ Në këndofshim librin (Mbretëri edhe revolucion) që ka nxjerrë Lenini më 1919 duke shkoqitur mësimet botëshkretuese të Karl Marksit merren vesh këto: Diktatura proletariatit qenka e domosdoshme, se ndryshe s'mund të shpëtojë bota prej borgjezisë, dmth prej pjesës së lartë, prej dorës së parë. Në kohën e revolucionit ç'të punojë diktatura qenka e pëlqyer, populli do të çnderohet, do t'u merren të gjitha pasuritë, gjithë të drejtat. Populli nuk paska të drejtë fare për të ngritur krye kundër diktaturës të kësaj ushtrie rrozgë! Kjo diktatura rrjepacake si të qëndrojë, si të rehatohet ngadalë-ngadalë vetvetiu na paska për të marrë formën e komunizmit! Kësisoj revolucione në histori nuk shihen gjëkund, por shihet nga çifuti Karl, i cili me këtë shkak si t'i rrënojë të gjitha fetë, me anë të çirakëve që la, të vendosë të dhjetë urdhërat e Teuratit, edhe kështu të mbretërojë vetëm Dekalogu i tyre!

plak dhe nuk do ta arrij dot Komunizmin (ku njerëzit hanë e pinë pa paguar!) prandaj desha ta shoh me sytë e mi se çfarë do të bëhet?! Pak rëndësi ka sesa e vërtetë është kjo histori, morali i saj është mjaft kuptimplotë. Komunizmi nuk ishte gjë tjetër veçse një utopi mashtruese që jeta njerëzore nuk mundi ta pranojë.

²¹ Kënduesit këtë çështje e kanë ndër mend. (H. A.) I referohet revolucionit bolshevik të dështuar të 1905-ës dhe disa përpjekjeve të mëparshme.

Ç'dobi ka një shtet kur fuqia rrjepacake për lan gjënë e botës pa një të drejtë dhe e gërmadhon krejt shtetin? Vallë si të gërmadhohet një shtet e si të shkretohet nga pasuria e nga gjithë ndërtesat mjeshtërore, edhe si të zhduket feja e morali atëhere nga ana e kujt do të ndreqen? Vallë si të theren e si të farohen ulematë, më të ditshmit, më të famshmit mjeshtër të një shteti sipas programit të Karlit, qysh u mirësoka vevetiu nga ajo diktatura e proletariatit? Luftën e përgjithshme e pamë. Qytetërimin e perëndimit e pamë. Udhëheqësit e imperializmit edhe të proletariatit i pamë. Por fundi, as ndonjë komb nga zgjedha nuk shpëtoi, por ndoshta iu shtua edhe ca më tepër zgjedha. Programi i Karl Marksit as Buharanë, as Hivën, as Hindin as... as... nuk e shpëtoi prej zgjedhës. Ç'bëri proletariati veç rrënimit e gërmadhimit"? Fjalët e Z. Musa Xharu-llahut këtu u sosën. Tani të flasim edhe pak përmbi shkrimet e të famshmit Abdu Rreshidit, i cili është nga më të mëdhejtë botë-shëtitës muslimanë edhe ka shkruar shumë sende të dobishme për njerëzimin e civilizimin e vërtetë. Zotëria e tij thotë: "Tartarët e Ruisisë kanë qenë fetarë të fortë. Mbretëria për t'i moskovuar (rusizuar) ata, mori masa të rrepta nëpër shkolla, edhe kështu brezin e ri tartar e përgatiti me ndjenja moskovite. Çunat e tregëtarëve filluan t'i vendosin nëpër shkollat e misionarëve rusë e kështu brezi i ri erdhi në një gjendje sa filloi të tallet me fenë e vet myslimane që e kishte trashëguar prej prindërve të vet. Si me gojë, si me gazeta po këta misionarë të rinj, këta bij të myslimanëve, thërrisnin botën muslimane edhe ca më tepër bijtë e të pasurve në fenë e moskovitëve. Bolshevikët iu turrën gjithë feve, por ca më shumë fesë orthodokse. Shumë kisha e xhami i dogjën, edhe priftërinjtë e hoxhët i ndoqën dhe fort i përpoqën e i çnderuan. Sot çifutët në Rusi tallen me priftërinjtë e me

ulemanë, se ia arritën qëllimit të vet. Nga më të mëdhejtë e ulemave muslimanë Shejh Xhemaludin Afganiu thotë në një libër pesëdhjetë vjet më parë, Komunizmi ka për të shkretuar botën, edhe ka për t'i shkukur rrënjët racës së njeriut. Propagandat e tyre bëhen kësisoj: “O vëllezër, a është e drejtë ju të ngratët të punoni gjithë ditën me shatë në dorë, në piskun e vapës, zbathur, zhveshur, e të hani bukë-thatë, të zotët e çifligjeve të rrijnë ndën hije, të flenë rehat, të shëtisin majë kalit, me araba (karroca), të bëjnë qejf e t’ju përdorin juve porsì kafshët? Ju mundoheni ditën dhe natën nëpër fabrika për bukën e gojës dhe të zotët e fabrikave të bëhen miljarderë? O burrani kapni pushkët t’i grijmë aristokratët e pasurinë e tyre ta ndajmë përgjithësisht se është toka e jonë, gjëja e jonë, por ata na i kanë grabitur...!”²² Oratorët me gjuhë të zjarrtë u bënë tërheqësit e tyre, nga fjalët e bukura të tyre gjaku u ndizet, mbase edhe qelepiri u shijon, kujtojnë se me të vërtetë me anën e kryengritjes do të gjejnë lumturinë, djegin, rrënojnë, vrasin presin e shkretojnë botën për fitimin e çifutëve, në fund po rrozgë që rrozgë, sa shkrihen kot. Përmbi rrënimet që shpalli programi çifut i Karlit sot në botë, si një shembull të gjallë kemi Rusinë, e cila është para syrit të gjithë botës. Ky rreziku i kuq, ky bretku i verdhë e kjo murtajë e murrme, nuk po gjen vetëm Rusinë, por pas programit të fshehtë mundohen të pushtojnë krejt botën, edhe përpiqen të mbretërojë diktatura bolshevike e dekalogu jahudi (çifut). Sot në Rusi nuk po lejnë as Kuran, as Inxhil, as libra fesh, le këto po edhe librat që nuk i shërbejnë bolshevizmit i djegin

²² E kam parë në një statistikë, shuma e të hollave të botës sikur t’i ndahen të gjithë njerëzisë, i bie sekujt 190 franga ari, që me kaq askush s’mundet të kryejë gjë. (H. A.)

edhe përdoruesit i grijnë. Gjithë librat e Tolstoit dhe të filozofëve të tjerë i dogjën. Muslimanëve po u vjen mbi kokë ai hall që u kishte ardhur në fillim të përhapjes, që e këndonin Kuranin fshehtazi edhe faleshin tinëzisht. Megjithë këto, më të zotët e rusëve si mjekë e avokatë po veshin petkun e priftërinjve dhe po përpiqen për fenë e vet. Gazeta Jeni Kafkasia thotë: Më 1917 si u bë revolucioni i madh i Rusisë u ngjall një qeveri edhe në Kaukaz me emrin Azerbajxhan. Bakuja duke qenë qyteti më i madh e qendër tregëtie, plot me popull musliman e turq, bolshevikët rusë dita-ditës duke shpikur mijëra intriga përpiqen që Bakunë ta shkëpusin nga Azerbajxhani dhe kësisoj t'ia heqin vetqeverimin krejt prej muslimanëve të atjeshëm. Bolshevikët që kishin dalë me një program aq të stolisur, me një maskë që do të ngjallnin vetqeverimin e çdo kombi, do të shpëtonin botën nga zinxhiri i zgjedhës, do të themelonin vëllazërinë e vërtetë në gjithë botën, filluan nga dhëlpëritë e veçanta dhe popullin e shkretë e futën në një moçal robërie më të qelbët se ishin më parë. Nga anëtarët e këshillit veprues të komitetit Jaruslangji dhe Petrovski pas hetimeve që bënë për Bakunë thanë se ky është një qytet internacional. Kështu, bolshevizmi edhe Bakun turk po e moskovizon. Azerbajxhani këtë qytet e ka pasur burimin e të gjitha të ardhurave shtetërore. Bolshevikët që do të ringjallnin vëllazërinë, ja sesi po mbytin më parë po ata vëllezër që i kanë në gjë të vet. Rrugët e Bakusë sot përmbajnë këto pllaka të kuqe me këto emra: Zinoviev²³,

²³ Grigori Jevsejeviç Zinoviev (1883-1936). Udhëheqës komunist **çifut**. I lindur në Ukrainë. Në 1906 anëtarësohet në Partinë Punëtore Social-demokrate, një lëvizje e fshehtë e udhëhequr nga Lenini. Në 1903 kur partia u përça, anëtarësohet në fraksionin bolshevik dhe jo në atë të menshevikëve. Në 1907 bëhet anëtar i Komitetit Qendror Bolshevik. Që nga 1909 ai punon dhe jeton me Leninin në Francë, Austri dhe Zvicër. Zinoviev drejton aktivitetin

Trocki, Lenin, Kalinin, Kamenev, Stalin, Shalumian, Çaparidze, Kazkanev, Fioletiev, Radek²⁴... etj

Kjo fletë na tregon programin e bolshevikëve duke thënë:

1. Komunizmi nuk pajton me asnjë fe se bazohet mbi pafesinë (ateizmin) se thotë: Zot s'ka, Profet s'ka, hasha, Zoti s'është gjë fare. S'është as një as disa. S'ka Zot që të ketë dhe Profetë. Profetët janë disa njerëz gënjeshtarë që librat i kanë përdorur si vegla për të rrjepur botën edhe të ushqeheshin në kurriz të tyre. Ata thonë se Teuratit, Inxhilit dhe Kuranit i ka shkuar koha.²⁵

“Thonë një kohë bota vepronte pas Kuranit e pas Inxhilit e Teuratit, edhe me këtë mënyrë siguronin jetesën, por sot çdo njeri duhet të rrojë me Kuranin e Karl Marksit”. - Plasja t'ju bjerë!

2. Shajnë agjërimin, namazin etj... Ata komunistë që shkojnë në xhami e falen, agjërojnë i çregjistrojnë, edhe nga partia i nxjerrin. Thonë: lumturia, shpëtimi vjen vetëm nga pafesia (ateizmi), nga mosbesimi, nga mohimi i Zotit, librave e Pejgamberëve, por vetëm nga veprimi me librin e çifutit Karl Marks.

3. Në të gjithë shkollat nga ana e profesorëve u thuhet: Zot s'ka... etj... etj.

Kush na shpëtoi nga zgjedha e besimeve të këqia? Kush na e pruri këtë lumturi?

Bolshevik në Rusi dhe mes deputetëve në Duma. Ka qenë kryetar i Kominternit (1919-1926) dhe anëtar i Byrosë Politike Komuniste (1921-1926) si dhe kryetar i Sovjetit të Petrogradit.

²⁴ Emrat e udhëheqësve të Byrosë Politike të asaj kohe në BRSS.

²⁵ Përmbi njësimin e Zotit e madhësinë e fesë këndon *Zanin e Naltë*. (H. A.) Organ i Bashkësisë Islame të asaj kohe.

Çunat me një gojë: “Nga ëndrrat e kota na shpëtoi Karl Marksi edhe shpirtmadhi Lenin”.

Profesori: “Pra, sillini (drejtohuni) nga shtati i bekuar i tyre dhe vini gishtin në zemër dhe bëjini temenanë e duhur”. Nxënësit dhe nxënëset përnjëherësh iu falen putave të tyre, dmth, putave të Karlit e të Leninit me shokë, sipas mësimit që marrin prej mësuesve, dmth, sot një çifut po njihet për Zot!

Për faqe të zezë! Mos më keq, o Zot i Madh!

Në shkollat e Varfanjakëve, kanë disa kuti shkruar sipër Allah, Muhamed, Isa, Mari, Marksi, Lenini, Trocki etj... Foshnjat që janë akoma pesë-gjashtë vjeç kërkojnë me radhë prej kutive duke thirrur emër për emër që t’u japin ngrënie. Kur thërrasin Allah, Muhamed, Isa, Mari nuk u vjen asnjë përgjigje, por kur thërresin emrat e çifutëve u vjen përgjigjia bashkë me një ëmbëlsirë. Me këso dinakëri foshnjat e mjera i ftohin e i largojnë nga Zoti, nga Pejgamberi edhe u ngjallin e u rrënjosin në zemër dashurinë për çifutët.

4. Komunizmi (bolshevizmi) formimin familjar s’po e njeh fare. Thonë që njeriut nuk i duhet të ketë martesë. Burri është burri dhe gruaja është gruaja. Nuk duhet nëna e ata të njohin bir e bijë. Qeveria është e detyruar t’i ushqejë dhe t’i rrisë sa fëmijë që të ketë shteti²⁶.

²⁶ Këtu na na jepet ideja e edukimit komunist që akademiku sovjetik Stanislav Strumilin (1887-1974), e shpreh me këto fjalë: “Çdo qytetar sovjetik, kur del nga materniteti do të dërgohet në çerdhe fëmijësh dhe nga ato në kopshte fëmijësh me qëndrim tërëditor ose në konvikt fëmijësh, pastaj në shkollë me internat, kurse së këndejmi me leje në jetën e pavarur, në prodhim ose në shkollim të mëtejshëm”. Po të njëjtën ide jep edhe Marksi në Kapitalin e tij kur thotë: “Fëmijët e të dy gjinive nuk duhen mbrojtur nga askush më tepër se sa nga prindërit e tyre”.

Si të virgjërat dhe të çvirgjërat njësoj janë, duhet të formohet jetimi familjar sipas bolshevizmit, dmth, s'do ta dinë cilin kanë bir e cilin kanë bijë e kësajsoj do të shpëtojnë nga gajleja e fëmijës, mirëpo më tutje babai ka për të marrë grua, të bijën që këtë s'e pranojnë as kafshët.

5. Kurorëzimi u hoq.

Një grua sa t'i dojë qejfi rron me një burrë, kur të mërzhitet shkon me atë që t'i pëlqejë. Gruas i mjafton të shkojë në noteri. Ata burra që kësaj i kundërshtojnë nga ana e qeverisë vriten.

6. Le që libra fesh nuk lenë në shkolla, por nuk lenë të shiten as nëpër librari. Historia fetare nga shkollat është hequr dhe u thuhet nxënësve që gjithë ata që janë përpjekur për fe e për atdhe janë xhelatët e kombeve, ata qenkan më të këqijtë e botës.

Gjithë trimat, herojtë, të famshmit që kanë shkruir jetën e tyre për Atdhe, bolsheviku i quan tradhëtar. Brezin e ri duan ta rritin me një mentalitet të shartuar prej çifutëve. Kanë dhe disa çështje të fëlliqura që penda dridhet e turpërohet²⁷.

²⁷ Këtu ia vlen të përmendim edhe Sigmund Frojd (1856-1939). I lindur në mesin e një familje të mesme **çifute** në Freiberg, themelues i psikoanalizës. Frojdi në teorinë e tij pretendonte se njeriu si qenie biologjike që kur lind priret drejt plotësimit të të gjitha dëshirave të tij instiktive në mënyrë krejt të shpenguar. Këto dëshira instiktive të errëta nuk njohin sipas tij, asnjë kufizim moral apo familjar, me fjalë të tjera njeriu nuk na qenka veçse shtazë e lindur e që ambienti e bën më pas njeri! Frojdi për të shëruar neurozat nervore i ftonte në një farë mënyre të sëmurët që të kënaqin instiktet e tyre, të cilat ai e quante rimarrje të ndërgjegjes që ishte bërë e pandërgjegjshme për shkak të frenimit të vetvetes. Me një fjalë pak a shumë një ftesë për shthurje, por që interpretohet si qartësi para vetvetes! Po ashtu ai pretendonte se energjia e instiktit seksual fillloka që me lindjen e fëmijës, psh, foshnja e porsalindur sipas tij e shfaq këtë prirje me thithjen që i bën gjirit të nënës! A thua se ai e thith atë nga epshi dhe jo nga uria! Ky është pra, Frojdi dhe teoritë e tij që në një farë mënyre i dhanë 'Revolucionit Seksual' të shek. XX justifikimin e ashtuquajtur shkencor.

Çkatërimet e bolshevizmit

Qeveria bolshevike e komuniste e Rusisë që prej fillimit e gjer më sot Rusinë e gërmadhoi, e shkretoi. Diktatura e ushtrisë e formuar nga më të këputurit e popullit në çdo pikëpamje, shteteve të Rusisë u kanë shpikur kijametet më të mëdha ekonomike, mjeshhtërisht, njerëzisht, shoqërisht, tregëtisht, familjarisht, moralisht edhe fetarisht. Argatët e ngratë, punëtorët e gjorë, bujqit e mjerë vetëm se janë bërë veglat e disa çifutëve dhe vetëm se po e derdhin gjakun e vet për interesin e disa personave dhe nuk janë gjë tjetër. Nga thonjtë e Tiranisë së kësaj fuqie të shtyrë, sot në Rusi kanë shpëtuar vetëm ata popuj që janë të zotët e vetes si Finlandezët, Estonët, Lehët, Lanishët e disa të tjerë. Për të nxjerrë në shesh shkatërrimet e bolshevikëve që i kanë prurë Rusisë fillimisht e gjer më sot duhet të mbushen disa volume. Por që prej fillimit të revolucionit edhe gjer në motin 1920 siç marrim vesh prej statistikave zyrtare që ka shpallur komisioni i quajtur ÇEKA po i shënojmë më poshtë. Njerëzia që janë vrarë me plumb nga ana e bolshevikëve gjer në Marsin e motit 1920 mbajnë shumën që shënohet poshtë:

Shkatërrimi njerëzor:

Të vënë në plumb	Veta
Prej më të mëdhejve fetarë	28
Priftërinj të përgjithshëm	1.215
Profesorë dhe mësues	3.775
Doktorë dhe farmacistë	3.800
Oficerë të mëdhej e të vegjël	547.500
Ushtarë që janë grirë në plumb	395.009
Policë të fshehtë	5.460
Nga pasanikët	12.950
Nga inteligjentët e intelektualët	655.250
Argatë, punëtorë	993.350
Shuma	2.618.337

Në befshim hesap edhe ata që janë grirë prej 1920-'25, padyshim shuma e të grirëve do të kapë tre milionë, që të cilët kanë shkuar kurban për hatrin e disa çifutëve. Por për çudi as ndonjë ushtar çifut s'është vrarë!

Qysh u mahnitën grinë vëllezrit
S'u turpëruan pak faqezezrit
Tre milionë kurbanë dhanë
Për çifut Marksini, për Jehudhanë.

Kijameti i drithit

Para luftës në Rusi mbledhej 60 miliardë kg grurë. Më 1923 u mor vetëm 600 milionë kg grurë. Para lufte dilte jashtë nëpër shtetet e huaja në mot vetëm 8 miliardë kg grurë, por sot megjithë ato fusha aq të gjera, të cilat ishin hambari i gjithë botës, për fat të zi Rusia po vdes për bukë.

Kijameti i bagëtisë

Para lufte në Rusi gjendeshin 21 milionë kuaj, tani ndodhen vetëm 8.648.000. Para lufte kishte 22 milion lopë, tashti ka vetëm 11.948.000 lopë. Para lufte kishte 79 milionë dele, sot kanë mbetur 13 milionë. Pas statistikës që u bë në motin 1914 në arkën e Rusisë gjendej vetëm flori 1.700.000.000 dhe një miliard e 633 milionë franga ari banknote.

Kijameti i fesë

Si kuptohet edhe nga statistikat dëmin më të madh e ka parë ortodoksia, që vetëm 1215 priftërinj i kanë grirë.

Nga ulematë janë varur shumë; por si janë bërë më tepër se 20 milionë persona me anën e kryengritjeve që janë bërë, qeveria bolshevike është shtrënguar ta lehtësojë programin pak. Fenë e ka ndaluar nëpër shkolla, edhe pa mbushur 14 vjeç fe s'këndohet.²⁸ Nga ky shkak shumica e popullit po mendohen të bëjnë hixhret (emigrim) e të shpërndahen në Afganistan, në Hindi e nga Persia e gjetkë...

²⁸ Në Shqipëri programin e Karl Marksit më parë e zbatoi ish-ministri i arsimit Rexhep Mitro. Vinjahu ia hoqi të drejtat fesë dhe Kuranit. Ankimet telegrafike që erdhën si shiu nga të katër anët e Shqipërisë, s'i hynë fare në vesh çirakut të

Një pjesë nuk e shohin të arsyeshme ikjen po duan të qëndrojnë me pushkë në dorë gjersa t'u respektohet feja muslimanëve si më parë, a gjersa të shkrihen fare. Në Rusi për xhamitë marrin aq vergji (taksa) të rënda sa populli mezi po i paguan.

Kur po i thernin e kur po i vinin në plumb të ngratët të pafajshëm, shpirti i tyre thoshte duke rënkuar:

Shih pra, nuk mbetën fare ndërtesa,
Ndër këmb' u muar e shenjta besa,
Xhami e kisha s'lan' i rrënuan,
Me kësi punësh djajt i shënuan,

Priftinjt e hoxhët si kec i grinë,
Inteligentët në dhet i shtrinë,
Ç'bëri Nemrudi²⁹, ç'bëri Shedadi,
Këto guxime as kush s'i pati.
Ç'bëri Firauni? Ç'bëri Hamani³⁰?
Ç'bëri Jezidi³¹? Ç'bëri Mervani?
Ç'bëri Haxhaxhi³²? Ç'bëri Sefahu?

Karlit. Kemi shpresë të madhe se kjo qeveri do t'ia përmirësojë plotësisht të drejtat shenjto-re të këtij populli që ua pat marrë nëpër këmbë ish-qeveri e parë. Se përndryshe brezi i ri moralisht e shpirtërisht po vdes. (H. A.)

²⁹ Nemrudi, i biri Kenanit, mbret i Babilonisë, ai që urdhëroi hedhjen e Ibrahimit a.s. në zjarr

³⁰ Firauni-Faraoni i Egjiptit që masakroi izraelitët dhe pretendoi se ishte zot ndërsa Hamani, ishte ministri i tij.

³¹ Jezid ibn Muavija. Halifi i dytë Emevij, njeri me vese, gjatë sundimit të tij vritet Husejni r.a. në Kerbela të Irakut.

³² Haxhaxh ibn Jusuf Eth-Thekafiu, guvernator në Irak dhe Horasan. Shquhet për gjakësorinë e tij, prej atyre që vrau ishte edhe sahabi Abdullah ibn Zubejri dhe Tabiuni Seid ibn Xhubejri. Vdiq në vitin 95 h.

Ç'bëri Karmati, Hasan Sabahu³³?
 Me lot prej gjaku vëllazër qani!
 U shkel Inxhili, u shkel Kurani!
 Ç'bëri Neroni³⁴? Ç'bëri Atila?
 S'bëri as njëri punë të tilla.
 Ç'bëri Xhengjizi³⁵ dhe Helagjuja³⁶?
 Sa thoi s'janë ato rrëmuja.
 As Timur-lengji³⁷ kështu s'ka bërë
 Shih historitë me radhë tërë,
 S'i bën Jexhuxhi³⁸ as qorr Dexhalli³⁹?
 S'besoj t'i bëjë këto as Djalli.
 Burrat i ndanë me zorr nga gratë
 Kush që bëzajti i dhanë shpatë.
 Jahë bolshevizma botë-rrënuese
 Shtriga stoliset bëhet si nuse,
 Gabon të ngratët partin e varfër

³³ Për këta të dy shih respektivisht shënimet 10 dhe 11.

³⁴ Perandor romak, diktator, i cili njihet si persekutor i të krishterëve dhe zjarrvënës i Romës

³⁵ Xhengjizi - ka për qëllim Xhengiz Khanin (1167-1227), perandor mongol që njihet si një nga pushtuesit më të mëdhenj në historinë e botës.

³⁶ Helagju ka për qëllim Huleghu Khanin (v. 663). Udhëheqës mongol dhe nipi i Xhengiz Khanit dhe një nga mbretërit e Tartarëve. Shquhet si njeri tiran dhe i shturur, ka vrarë një numër të pallogaritshëm muslimanësh, është po ky njeri ai që shkatërroi Bagdadin, vrau Halifen dhe dogji bibliotekën e Bagdadit një nga më të mëdhatë e kohës.

³⁷ Timuri ose ndryshe Tamerlani (1336-1405), pushtues mongol, përgjegjës për vrasjen e qindra mijëra njerëzve.

³⁸ Jexhuxh (Gog) një fis i madh njerëzish, i cili bashkë me Maxhuxhët (Magog) në kohën e Dhulkarnejnit bënin shkatërrime në Lindje dhe që do të rishfaqen përsëri. (shih Sure Kehf: 94-99).

³⁹ Dexhali ose Antikrishti. Dalja e tij shënon një nga shenjat e mëdha të Kiametit.

Me fjalë t'ëmbla i përmbledh afër
Të gJORËT derdhin kot më kot gjakun
Gjoja do marrin prej botës hakun,
Një vegl' e verbët, u bën u grinë
Kurban po shkojnë për Jahudinë,
U shkel Inxhili, u shkel Kurani
U gri Rusija, u gri Turani.

Me se po bëhet e ditur që bolshevizmi, komunizmi është themeluar nga çifutët edhe prej syresh po qeveriset⁴⁰?
Sot çifutët me shoqëritë dhe me formimet që kanë, rreptësisht dhe fuqi-plotësisht po mbretërojnë në këto shtete:

⁴⁰ P.sh. Ëalter Beniamin (1892-1940), **Çifut** i lindur në Berlin një nga teoricienët marksistë të kohës. Otto Bauer (1881-1938), **Çifut** i lindur në Vjenë, lideri i lëvizjes socialiste austriake para Luftës së Dytë Botërore. Julius dhe Ethel Rosenberg pasardhës të emigrantëve **çifutë** nga Bashkimi Sovjetik në SHBA, ishin në qendër të një nga proceseve më famëkeqe të spiunazhit gjatë Luftës së Ftohtë. Arrestohen nga Byroja Federale e Hetimeve (FBI) në verën e vitit 1950, nën akuzën spiunazh në favor të Bashkimit Sovjetik për të cilën do të dënohen edhe me vdekje dhe ekzekutohen më 19 Qeshor 1953.

Rosa Luksemburg (1871-1919), një nga udhëheqëset e teorisë socialiste dhe themeluesja e Partisë Komuniste Gjermane. E lindur në një familje tregtare **çifute** në Poloninë Ruse merr pjesë aktive në lëvizjet komuniste të kohës që nga viti 1887. Më 1889 shpërngulet për në Zvicër ku ajo ndihmon aktivisht për themelimin e Partisë Socialiste Polake në 1893. Me anë të martesës ajo arrin të marrë nënshpëtimin gjermane ku më pas do të bëhet udhëheqëse e ekstremit të majtë në Partinë Social-Demokrate Gjermane. Bashkë me Karl Libkneht themelojnë në 1916 Ligën radikale **Spartacus** që në Dhjetor të vitit 1918 do të bëjë Partia Komuniste Gjermane.

Kinë, Turqi, Rusi, Gjermani, Holandë, Belgjikë, Francë, Angli, Amerikë veriore edhe jugore. Sot në Nju Jork fabrikat për veshje, pjacat e shitjes, bankat më të pasura⁴¹, udhët e hekurta janë gjitha të çifutëve. Sot në botë po nuk u siguroa marrëveshja me çifutët, punët e botës nuk mund të ecin në boshtin e rodhanit që duhet. Rotshildi⁴², ai baroni me nam, çifut është dhe ky i ka hyrë Anglezit edhe në damarë, është bërë mbreti i pjacës i naftës për të gjithë botën. Këshilltari i Vilsonit, këshilltari i Klemansosë edhe i Lloid Xhorxhit⁴³ po çifutë kanë qenë. Ky komb i faruar aq fort që ka rreth 20 milionë, sot po e sjell Anglinë dhe Amerikën vërdallë si ua ka ënda. Gazetat politike të Anglisë,

⁴¹ P.sh. Joseph Seligman (1819-1880), i rrjedhur nga një **familje çifute**, themelon një banke internacionale, e cila konsiderohet si Instituti financiar më i madh në Nju Jork. Po ashtu edhe Xhoxh Sorros lindur më 1930 në Budapest nga një **familje çifute**. Kur trupat gjermane okupuan qytetin në 1944 arrin të shpëtojë kokën duke përdorur identitet të falsifikuar. Shquhet si kambist, me anë të së cilës është bërë miliarder, por edhe spekullator burse, kështu më 1992 brenda vetëm një dite do të fitonte 1 bilion dollarë duke bërë që Paundi Britanik të binte në vlerë. Po të njëjtën gjë bëri edhe në Malajzi në 1997, duke i sjellë asaj vështirësi ekonomike të shkaktuara nga shkëmbimi valutor, por që në mënyrë të sukseshme do të kapërceheshin nga përpjekjet e kryeministrit malajzian Mahatir Muhamed, i cili edhe do t'i demaskonte spekullatorët e bursës, në këtë rast Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe një konspiracion çifut, në krye të të cilit qëndronte Xhorxh Sorros. Por kambizmi mesa duket nuk është fusha e vetme në të cilën ai shtrin veprimtarinë e vet, ai ka shpenzuar me miliona dollarë për të ndihmuar atë që ai e quan 'hapje të shoqërive të mbyllura' drejt Perëndimit.

⁴² Familja **çifute** Rothshild e përbërë nga pesë djemt e Majer Amshel Rothshild (1744-1812), kontrolluese e një shoqërie ndërkombëtare bankash e quajtur "The House of Rothschild", e cila edhe sot e kësaj dite vazhdon të ushtrojë një ndikim të fuqishëm.

⁴³ Sipas radhës, presidenti i SHBA-së dhe kryeministrat e Francës e të Anglisë të atyre viteve.

fletoret e përkohshme⁴⁴ metalet, qymyr e hekur, edhe vaporët më të shumtë e nga më të pasurit e më të mbrothshmit e më të dobishmit të botës po në duart e këtij kombi janë.

Hordhitë e Gjermanisë, më fisnikët (oxhaqet-aristokratët) e Gjermanisë, fisi më i nderuar e mbretëror i Hohenzolernit e i Habsburgëve në këta mbështeten.

Në Austri po ky komb mbretëron⁴⁵.

Nafta e Rumanisë po në dorë të këtyre është.

Çekosllovakia në dorën e tyre, po qëndron.

Gjithë shoqëritë masone që ndodhen në botë vërtiten po në dorë të çifutëve (si Kara Suja në Turqi). Axhans Rojteri, stacionet e telegrafeve pa tel janë të këtyre. Metalet e Kalifornisë, pambuku i Egjiptit, elmazet e Kabit janë të gjitha të çifutëve. Politikanët më të zotë e të ditur që nxorri shekulli i fundit janë çifutë. Jehudinjtë me anën e mbretërimit financiar që kanë sot në dorë e sjellin botën vërdallë.

Një çifut Haxhi Iljazi ishte ai që vrau në Azerbajxhan gjithë ato gjeneralë, shkrimtarë, politikanë, ministra, oficerë dhe ushtarë me mijra. Ndihmësi i kryetarit të komisionit (ÇEKA) në Azerbajxhan, Koberkoni një çifut është.

⁴⁴ P.sh., Robert Ian Maksuell (1923-1991). **Çifut** i lindur në Çekosllovakia, manjat i medias, në 1981 arriti të shpëtonte British Printing Corporation nga kolapsi financiar, të cilën e riuajtiti “Maxwell Communications Corporation”. Në 1990-ën themeloi një nga perandoritë botërore më të mëdha të medias. U gjet i mbytur në Atlantik në rrethana misterioze.

⁴⁵ P.sh., Bruno Kraiski (1911-1990). Austriako-**çifut**, udhëheqës i social-demokracisë, Kancelar i Austrisë (1970-1983) dhe ndoshta shtetari më influencues austriak i pas-luftës. Lindur në një familje vieneze **çifute**, Kraiski bëhet anëtar i Partisë Socialiste që në moshë të re. Kraiski është gjithashtu themelues i Rinisë Revolucionare Socialiste gjatë luftës.

Në të gjitha kasaphanet, në gjithë ato ndërtesa që japin gjykim për vrasjen e të pafajshmëve çifutët ndodhen. Gjaku i pafajshëm i botës që po derdhet është nën dy gjuhët e penave të çifutëve. Qepshtejni, Tifrisi, Xhagini, Eminesku edhe si këta shumë të mëdhej që ndodhen në Azerbajxhan çifutë janë, dmth; çifutët sot po e mbarojnë botën së griri.

Siç thamë më sipër mazonizmin, komunizmin, bolshevizmin ato e ngjizën, ata po e mbajnë, ata po e dredhin dhe po e përdredhin. Sot në Rusi komisioni i madh që përmban bolshevizmin është prej 17 burrash, 12 janë çifutë. Nënpunësit e mëdhej të Rusisë janë 550, po 450 janë jehudi, vetëm 100 janë rusë, edhe Trocki çifut është⁴⁶. Edhe kryetari i socialistëve Karl Marksi çifut është. Në çdo lëvizje, në çdo luftë që ngjan, po aty do të jetë kuptimi e mendimi i lartë i çifutëve.

Në luftën e Rifit në Fes (Marok), në Hixhaz, mbase edhe në Turqi e në Kurdistan është gishti i fshehtë i çifutëve, kudo-kudo ai gisht po luan rolin. Çifutët pas mendjes së thellë të diplomatëve të tyre, me qenë se janë të lidhur me një program të fortë e të fshehtë, faqezij sado që duken si pa fe, por ata kurrë nga feja s'largohen.

⁴⁶ Leon Trocki, emri i tij i vërtetë është Lev Davidoviç Bronshtain (1879-1940). Njeriu i dytë pas Leninit si organizator dhe udhëheqës në fazën bolshevike të Revolucionit Rus në 1917. Trocki ishte i biri i një fermeri çifut nga Janovka në Ukrainë. Në 1902 ai takohet me Leninin dhe futet në radhët e Bolshevikëve. Në Shtator të 1917-ës zgjidhet kryetar i Sovjetit të Petrogradit dhe nga ky post ai organizon forcat bolshevike për të përmbysur regjimin e Aleksandër Kerenskit. Në 1918-25 bëhet komisar i luftës. Nga mbeturinat e forcave të demoralizuara cariste ai organizon Ushtrinë e Kuqe. Mbas vdekjes së Leninit, Trocki i vënë para luftës për pushtet nga Stalini do të përjashtohet nga Partia dhe në Gusht të 1940-ës do të ekzekutohet nga agjentët e Stalinit në kryeqytetin meksikan ku ai kaloi vitet e fundit të jetës.

Çifutët besojnë sigurisht se pas pak vjetësh, mbretërinë e Samoelit që kanë sot në Kuds (Jeruzalem) do t'ia shtrijnë gjithë faqes së dheut, edhe pas gjysmë shekulli a një shekull pak nga pak do të shtien themelet e jehudizmës nëpër shkollat ashtu si duhet, dmth, do të bëhen gjithë bota çifutël! Çifutët që sot të dhjetë urdhërat, porsi rrufeja me anën e kinemasë i përfytyruan në gjithë botën⁴⁷, d.m.th., që tashti filluan nga Jehudizma.

A mund të përhapet bolshevizmi?

⁴⁷ Këtu mund të përmendim akuzën që bëri para disa vitesh në stacionin amerikan CNN aktori i mirënjohur Marlon Brando se çifutët janë padronët e vërtetë të Hollivudit dhe se gjithshka bëhet sipas dëshirës së tyre.

Disa diplomatë thonë se nuk mundet të përfshijë gjithë botën. Se në Rusi vërtet u përhap, po ishte shkaku se 22 milionë bujq punonin vetëm për çifligjet e fëmijës së perandorit (carit). Mbase edhe çifutët për të nxjerrë atë dufin e vjetër prej Ruisë që i kishte grirë disa vjet më parë, por se derdhën edhe shumë të holla në Rusi, veçanërisht edhe lufta e përgjithshme u ndihmoi, edhe kësisoj me anën e njerëzve të paguar e me anën e bujqve çelën luftën. Në shtetet e tjera kjo nuk mund të bëhet kaq shpejt, se populli i asnjë shteti nuk është i robëtuar sa populli i Ruisë. Sa për shtetet muslimane, me qenë se ndër ta nuk gjenden fabrika që me anën e punëtorëve të nxjerrin ngatërresa, edhe me qenë se në shtetet muslimane tokat janë aq të gjera sa më të shumtat s'munden të punohen, nga ky shkak bolshevizma s'mundet të hyjë e jo të përhapet, çifutët sikur t'i derdhnin të hollat jo me harar (me thes), po me hambarë ndër muslimanët bolshevizma s'ngjallet. Mundet të gjenden ndër ata edhe disa që s'njohin as Zot, as Pejgamber, as kombësi, edhe me anën e të hollave që do të marrin prej çifutëve ndofta do të përpiqen që ta helmojnë popullin e tyre, por kurrë nuk munden ta kryejnë.

Muslimanët nuk kanë nevojë për bolshevizmin, se në fenë muslimane mbretëron demokracia edhe vëllazërimi i përgjithshëm. Në jetën njerëzore edhe ligjore Muhamed Mustafai a.s. s'kishte aspak ndryshim prej shokëve. Zekati, fitri siguron vëllazërimin e socializimin fetar.

A është frika se mos hyjë në Evropë?

Disa diplomatë thonë, me qenë se në Evropë ndodhen fabrika shumë, frika është se në ngjafte ndonjë luftë prapë, shumicën e ushtrisë e formojnë punëtorët mundet që ta përdorin pushkën tërthorazi e kështu ka për t'u rrënuar bota. Dikush pretendon ndryshe.

Vallë shtetet e huaja ç'po bëjnë?

Të gjitha shtetet, ca më tepër Anglia e ka kuptuar fort bukur që prej socializmit që është formuar kaq vjet më parë, do të delte pas kohe një çifutizmë, e cila do ta tundte gjithë botën si nga feja, nga morali⁴⁸ e nga çdo pikëpamje njerëzore e qytetërimore që me kohë i pat marrur masat. Por disa diplomatë duan të thonë se Anglia për t'i bërë ballë bolshevizmit duhet të bashkohet edhe me botën muslimane. Politikisht kështu, por edhe shpirtërisht gjithë bota për të shpëtuar nga zjarri i skëterrës që ndezi Karl Marksi, bota e krishterë si Anglia, Italia, Bullgaria etj... feve po iu japin një rëndësi të madhe. Kongresi që u bë në Birmingham, ndën kryesinë e nderit të perandorit. Kongresi që u bë në Romë ndën kryesinë e Papës e gjetkë thuhet se u bënë për t'i bërë ballë jehudizmes, dmth, sprijës bolshevike. Ajetin që e shënuam në krye e provuam edhe me dokumenta historike të gjalla që s'kanë sesi mohoen.

Nga goja e Abdu-Rreshidit:

⁴⁸ Ja seç thuhet në një nga protokollet cioniste: “Duhet të punojmë për shkatërrimin e moralit të çdo populli, që të na mundësohet të sundojmë të tjerët. Frojdi është i yni, ai do të vazhdojë t'i paraqesë marrëdhëniet seksuale haptazi, ashtu që te rinia të mos mbetet asgjë e çmuar, qëllimi final i saj të jetë plotësimi i dëshirave seksuale. Atëherë shkatërrohet morali i tyre”. Dhe kjo është në fakt ajo që ata kanë arritur!

Tufanit të bolshevizmës veç fesë kush i bën ballë?
Po u çkatërrua feja kush i rri përpara vallë?
Atdheu edhe kombësija me Fe me Fe mbahet vetëm.
Bolshevikët po i shohim Atdhen' e sjellin vërdallë.

Fjalët shkurt: çifutët me dhelpëri e me të holla duan të luajnë një rol që le fetë që do t'i humbasin, po duan edhe gjithë botën ta përdorin si kafshë, se ata besojnë që Zoti gjithësinë për ata e ka krijuar, edhe të gjitha pasuritë të tyre janë⁴⁹. Pra, me çdo mënyrë që t'i grabisin prej të tjerëve i quajnë hallall. Ata shpresojnë se Inxhilin e Kuranin do t'i ngrejnë dhe do të vendosin dekallogun, dhjetë urdhërat e Teuratit. Pa i dhënë fund të sjellim një shembull historik përmbi bolshevizmin (socializmin). Bolshevizmi është shumë i vjetër. Shumë herë është ngjallur edhe ka vdekur. Në një libër të vjetër arabisht me emrin *Çuditë e botës* kemi parë historinë që po e shkurtojmë këtu⁵⁰: “Disa mijëra vjet përpara në një nisi⁵¹ të madhe të Hindit paska qenë një komb që rronte me një bolshevizmë, bashkë-jetesë e plotë.

⁴⁹ Ja seç thotë një Enciklopedi e huaj për **Protokollet Cioniste**: Këto dokumente përmbajnë planet e menduara për një mbisundim të botës nga ana e **Çifutëve**, të cilat thuhet se janë parashtruar nga Cionisti Theodor Herzl dhe të tjerë në Kongresin e Parë Cionist në Basel të Zvicrës, në 1897 dhe të publikuara në Rusi, fillimisht në formë të përmbledhur në 1903 dhe të plota në 1905. Të titulluara në versionin e plotë si “*Protokollet e Mësimeve të Pleqve të Cionit*”. Dokumenti në fjalë gjithashtu implikon edhe Masonizmin, liberalizmin dhe socializmin në komplot për të minuar Krishtërimin.

⁵⁰ Megjithëqë më duket si përrallë po e shkruaj se është interesante. (H. A.)

⁵¹ Nisi – ujdhesë ose ishull.

Nisi e tyre ishte e përforcuar me kala të forta, prej armiqve rronin të shkujdesur. Mjeshtëritë i kishin të ndara. Qyteti i tyre paska qenë fort i madh. Atje paska pasur disa ndërtesa të veçanta edhe shumë të mëdha. Në një ndërtesë rrinin artistët, mjeshtrit që punonin. Në një ndërtesë të madhe qenkan vendosur gratë, natën burrat për fjetje shkuakan atje!

Vjershë

Qysh merret grua nëna e bija?

Këtë s'e bëjnë as bagëtija.

Gjeli këputet nuk e shet nderin

Ta përjashtojmë nga kafshët derrin.

Për të ngrënë bukë, në kohë të caktuar shkojnë në gjellëtoren e përgjithshme. Për fëmijët që lindnin paskan pasur një ndërtesë të madhe të veçantë, që në të cilën rriteshin nga rritëse të veçanta plaka.

Atje paska pasur edhe një dergjishte⁵² të madhe me mjekë të ditur e me tërë veglat e duhura.

Të mos e zgjatim, këta me këtë mënyrë një kohë të gjatë paskan rrojtur gjoja me një lumturi të madhe! Pas një farë kohe qenkan mërzitur prej lindjeve edhe paskan pirë barin e shterpësisë e kështu në pak kohë ai komb qenka faruar dhe si nuk mbetën të rinj për të mbrojtur shtetin, veçse plakave e pleqve, fqinjët kanë ardhur dhe i kanë pushtuar dhe ky komb është faruar krejt ndën shpatat e tyre”.

⁵² Dergjishte – Nga dergjë-sëmundje, dergjishte për spital.

Nga Mexhusët⁵³ e Hindit dhe të Kinës shumë herë shohim që kanë shpikur nga një lloj bolshevizmi, por jetën e kanë patur të shkurtër dhe kufirin të ngushtë.

Edhe në kohën e Harun Rrashidit⁵⁴, një Mexhusit ngjalli në Bagdad një lloj bolshevizmi, por u zhduk shpejt.

Siç merret vesh edhe prej dokumentave historike, me shpirt u bë e ditur që bolshevizmi është shkatërrimi i njerëzimit. Zoti e çporrtë! Amin!

Referencat e përdorura për poshtëshënimet:

1-*Kurani Kerim, mea esab enuzul li Sujuti*, Dar Rreshid, Damask

2-*Kurani, përktim me komentim*, Sherif Ahmeti.

3-*Shpjegimi i kuptimeve të Kuranit të lartë*, Dr. Takiu-din El-Hilali dhe Dr. Muhsin Khan. (shqip) Darus-Salam, Riad.

4-*Islami ndërmjet Linjes dhe Perëndimit*, Alija Izebegoviq, Logos-A, Shkup 1993.

5-*Le ta dijë Rinia*, Abdullah Nasih Ulvani.

6-*Hyrje në Filozofi*, Instituti i Studimeve Pedagogjike, Tiranë 1994.

7- *Enciklopedia e thjeshtuar e feve, medb'hebeve dhe e franksioneve aktuale*, botim i ËAMY-it, 1420 h.

8- *Microsoft® Encarta® Encyclopedia 2000*

⁵³ Mexhus emër arab për Zoroastrianët, zjarr-adhuresit.

⁵⁴ Harun Er-Rreshid (766-809), Halifi i pestë abasid dhe më i famshmi i kësaj dinastie.

9-Grolier Multimedia Encyclopedia 1999.

10-Disa të dhëna janë marrë edhe nga fusnotat e *Xhenabu Sabih limen bedele dinel Mesih*, Ibn Tejmije.

Bibliografi kronologjike e veprave të Hafiz Ali Korçës

1. Mevludi, 30 faqe, botuar më 1900.
2. Treqind-e tri fjalët të Imami Aliut, Korçë, Shtyp. "Korça", 1910.
3. Mevludi a jet' e pastër e Pejgamberit, Shtypje e 3-të, Shkodër, Shtyp. "Nikaj", 1918.
4. Mevlud, I përkthyer në gjuhën shqip prej Mevludit turqisht që ka përkthyer i shenjtëruari Suleman prej Shaban Mulla Hysen. Korçë, Shtyp. "Korça", Koti & Xoxe, 1919.
5. Myslimanësia. Korçë, Shtyp. "Korça", Koti & Xoxe, 1919.
6. Jusufi me Zelihane a me e bukura e ngjarjeve (Absen-ul-Kasas), shkruar më 1315/1896 Elbasan, Shtyp. "Elbasani", 1923.
7. Shtatë ëndrat e Shqipërisë prej Hafiz Ali, Tiranë, Shtyp. "Mbrothësija", 1924.
8. Sadi, Gjylistani a Trandafilishta, përkthyer nga librat me te sakta prej Hafiz Aliut, shkruar në Tiranë 1917, "Mbrothësija", Kristo Luarasi, 1925.
9. Bolshevizma a çkatërim i njerëzimit, Tiranë, Shtyp. "Mbrothësija", 1925.
10. Kurani i madhënushim e thelbi i tij, Shkodër, Shtyp. "Ora e Shkodrës", 1926.
11. Historija e shenjtë dhe të katër Halifetë, Tiranë, Shtyp. "Gutenberg", 1931.
12. Mevlud, bot. i 2-të, Grosvenor Dale Conn. (Amerikë), Shoqëria "Mallëngjim", 1932.
13. Rubaijjati. Katroret e Umer Khajjamit, Shtyp. "Shkodra", 1942.
14. Shtatë ëndrat e Shqipërisë, bot. i 2-të, Shtyp. e Shtetit, 1944.
15. Abetarja arabisht, Shkodër, Shtyp. "Ora e Shkodrës", 1945.
16. Mevludi/ Lindja e Pejgamberit, Përg. Feti Mehdiu, Prishtinë, "Bëmirësia Kolektive", 1992.
17. Bolshevizma a çkatërimi i njerëzimit, H. ALI, Botim' Dytë, 1414=1993, Albanian Islamic Center, Harper Woods, Mich., U.S.A.
18. Shpjegimi i kuptimit të disa sureve të shkurtëra të Kur'anit të Shenjtë, Harper Woods, Amerikë, Albanian Islamic Center, 1996.
19. Tefsiri i ajetit që tregon profetësinë e përgjithshme të Muhamedit (A. S.), Harper Woods, Amerikë, Albanian Islamic Center, 1996.
20. Jusufi e Zelihaja, Hafiz Ali Korça, Harper Woods, Mich. USA,

Albanian Islamic Center, 1997.

21. Bolshevizmi është shkatërrim i njerëzimit, Hafiz Ali Korça, Biblioteka "Lexo", botues prof. dr. Feti Mehdiu, Prishtinë 2001.

22. Muslimanija, Mësimet të besimit mysliman për shkollat fillore, (Botim i Degës s'Arësimit), pa vit botimi.

Vepra e pabotuar e Hafiz Ali Korçës e mbetur në dorëshkrim

1. Besimet Islame dhe filozofitë e feve të ndryshme edhe partitë në fetë Islame, fq. 400 prozë e pabotuar e përfunduar në dorëshkrim më 1900.
2. Dumeneja dhe Kelileja, prej sanskrites, fq. 500 prozë e pabotuar e përfunduar në dorëshkrim më 1900.
3. Fjalë të Arta prej mendjesh të larta e prej gjuhësh të zjarra, fq. 200 prozë e pabotuar e përfunduar në dorëshkrim më 1910.
4. Përhapja e Fesë Islame, fq. 600 prozë e pabotuar e përfunduar në dorëshkrim më 1914.
5. Ilmi Bejan (Retorika) fq. 100 prozë e pabotuar e përfunduar në dorëshkrim më 1917.
6. Tefsiri i Kuranit, fq. 2.000 prozë e pabotuar e përfunduar në dorëshkrim më 1920.
7. Vjershërimi, fq. 50 prozë e pabotuar e përfunduar në dorëshkrim më 1920.
8. Logjika, fq. 54 prozë e pabotuar e përfunduar në dorëshkrim më 1924.
9. Proverbët Shqip, fq. 1.000 prozë e pabotuar e përfunduar në dorëshkrim më 1924.
10. Muhammed Hanefiu me Gjylnarin, fq. 100 prozë e pabotuar e përfunduar në dorëshkrim më 1939.
11. Vuajtjet dhe dënimet e mia me vdekje, fq. 300 prozë dhe vjershë e pabotuar e përfunduar në dorëshkrim më 1939.

*Të dhënat e nxjerra për veprën e pabotuar janë nxjerrë nga studimet e dr. Ismail Ahmedit.

Pasthënie

Janë 11 dorëshkrimet e pabotuara të H. Aliut, si dhe 13 të tjera që e kanë parë dritën e botimit, të cilat tregojnë për pjellorinë e tij si shkrimtar, si dhe gjerësia e temave të rrokura prej tij tregojnë njohuritë e

thella që zotëronte. Shihet qartë nga titujt e përmendur më sipër se ai e njohte mirë filozofinë, retorikën, logjikën, rregullat e vjershërimit, fonetikën arabe, si dhe folklorin shqiptar. Ai u mundua gjatë jetës së tij tokësore të jepte një kontribut të ndjeshëm për kulturën shqiptare, e cila sapo kishte filluar të mernte fizionominë e saj kombëtare. Kontributi i tij u pre ndjeshëm menjëherë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore dhe marrjes së pushtetit nga Partia Komuniste e Shqipërisë me në krye Enver Hoxhën. Janë 5304 faqe në dorëshkrim sipas bibliografisë së veprës së pabotuar të mësipërme. Disa tituj si: Mevludi i tij, i cili është ribotuar disa herë, po ashtu edhe “Shtatë ëndrrat e Shqipërisë”, “Jusufi e Zelihaja”, vepra të cilat janë ribotuar, por që nuk e kalojnë në numër Mevludin, duke parë edhe kërkesat e larta që ka pasur ky i fundit ndër shqiptarët. Në këtë botim është përfshirë edhe “Bolshevizma”, e cila pas dritës së botimit të parë, ka parë edhe dy botime të tjera, njëri në Miçigan, SHBA dhe Prishtinë. Po të njëjtat arsye që kanë pasur botuesit e Miçiganit dhe të Prishtinës, janë edhe tonat, por që jemi munduar ta plotësojmë më mirë nga pikëpamja studimore. Një arsye më tepër për këtë botim studimor special është se 50 vjet më parë Hafiz Ali Korça do të ndahej nga kjo jetë, duke ia dorëzuar kështu shpirtin Krijuesit të Tij, Zotit të Madhëruar.

R.A. Hysa